



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:225763
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05486882

C.nr.3294/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Diora Bajrami, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.H. nga Prizreni me numër personal të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. B.K. dhe F.K. që të dy nga Prizreni, kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 260.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit M.H. nga Prizreni.
- II. DETYROHET e paditura, M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, Prishtinë, që paditësit M.H. në emër të shujtave ditore për 99 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën kohore prej datës 01.01.2022 deri më datën 15.11.2022), t'i kompensoj shumën e përgjithshme prej 198.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë më datë 24.10.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 260.00 euro, përkatësisht shuma prej 62.00 euro, për 31 ditë pune për vitin 2022 (për periudhën kohore prej datës 16.11.2022 deri më datën 31.12.2022).

A r s y e t i m

Paditësi M.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me objekt të kontestit kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 260.00 euro.

I autorizuari i paditësit në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në QBMK "Nënë Tereza" në Prizren. Ka shtuar se paditësit i takon kompensimi për shujtat ditore nga 2 euro për çdo ditë pune, sipas nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe

Ligjit të Punës, por që e paditura nuk e ka bërë kompensimin për ditët e pranisë në punë nga 2 euro, prej datës 01.01.2022 deri më 15.11.2022. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se kundërshton shumë e kërkuar nga paditësi, me arsyetimin se nuk është realizuar për asnjë punonjës, për shkak të mungesës së mbështetjes buxhetore. Po ashtu, kërkesa e paditësit është parashkuar në përputhje me nenin 87 të Ligjit të Punës. Gjithashtu, një kompensim i tillë nuk është paraparë me asnjë dispozitë ligjore të Ligjit të Punës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë nuk është e obligueshme, përderisa nuk parashihet me ligj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës tek e paditura, përkatësisht në QBMK “Nënë Tereza” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër protokollit 81/2023 të datës 30.03.2023, të lëshuar nga drejtori i QBMK “Nënë Tereza” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësi M.H. është në marrëdhënie pune pranë kësaj shkolle dhe i njëjti gjatë vitit 2022, ka punuar gjithsej 130 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë nga data 01.01.2022 deri më 15.11.2022, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj pasi që vërtetimi është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, gjykata ia fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës, konkretisht paditësi M.H. është në marrëdhënie pune në QBMK “Nënë Tereza” në Prizren dhe për vitin 2022, ka gjithsej 130 ditë pune, pra këto ditë përfshijnë tërë vitin 2022.

Bazuar në faktet e çështjes, gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkuar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi më datë 22.01.2021. Po ashtu, me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023 e datës 09.10.2023, parashihet periodha kohore e zbatimit të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021.

Me nenin 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë “të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët

e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”.

Nga gjendja faktike e vërtetuar, rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësi M.H. për vitin 2022, ka realizuar gjithsej 130 ditë pune. Andaj, gjykata ka vlerësuar dhe llogaritur se nga data 01.01.2022 deri më datë 15.11.2022, paditësi ditë pune të realizuara i ka gjithsej 99 ditë pune e që në rastin konkret të njëjtit i takon shuma prej 198.00 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 99 me 2 euro (99 x 2 euro = 198.00 euro), pra gjykata paditësit i ka llogaritur ditët e prezencës në punë në periudhën e kërkuar nga dt.01.01.2022 deri më 15.11.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, sa i përket pjesës aprovuese është bazuar në nenin 398 të LPK-së, pasi që nuk ka ekzistuar asnjë pengesë për të aprovuar si të bazuar një pjesë të kërkesëpadisë së paditësit dhe se kjo pjesë e kërkesëpadisë bazohet në dispozitat ligjore të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kësisoj, me nenin 398 të LPK-së përcaktohet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (24.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vlerësoi se pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit është e pabazuar në ligj. Kështu, në pikën III. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023 e datës 09.10.2023, parashihet se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, zbatohet nga data 22.01.2021 deri më datë 21.11.2022. Së këndejmi, gjykata pas llogaritjes së bërë ka gjetur se sipas vërtetimit për prezencë në punë për vitin 2022 paditësja ka realizuar 130 ditë pune e cila ka përfshirë tërë periudhën e vitit 2022, andaj marrë parasysh kërkesën e paditësit sa i përket kompensimit të shujtave për periudhë kohore nga dt.01.01.2022 – 15.11.2022 gjykata gjeti se nga data 16.11.2022 deri më datë 31.12.2022 për këtë periudhë ekzistojnë gjithsej 31 ditë pune apo në shumë prej 62 euro. Andaj, meqenëse paditësja për tërë vitin 2022 ka realizuar 130 ditë pune, të njëjtës i janë minusuar 31 ditë të cilat përfshinë periudhën e ditëve në punë pas datës 16.11.2022, andaj mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e

kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Ndërsa, lidhur me kundërshtimin se kërkesa e paditësit është parashkruar sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, gjykata gjeti se një kundërshtim i tillë është tërësisht i pabazuar. Kështu, paditësi ka kërkuar kompensimin e shujtave ditore për periudhën kohore nga data 01.01.2022 deri më 15.11.2022, ndërsa padinë e ka parashtruar më datë 24.10.2023. Pra, paditësi ka parashtruar padi për kompensimin e shujtave ditore pa kaluar afati prej 3 vitesh, të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës dhe rrjedhimisht kërkesa e paditësit është bërë pa kaluar afati për parashkrimin e një kërkesë të tillë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitën e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3294/2023, datë 21.03.2024

G j y q t a r j a
Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi, pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate Themelore.